



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA JURIDIKE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Vlorë, më ____ . ____ . 2025

PROCESVERBAL-Tipi i kontratës - Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është përefekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Rikonstruksioni i rrugës së varrezave në fshatin Kaninë”
KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45210000-2, Punime ndërtimi.

VLERA E FONDIT LIMIT: 28,429,067.37 (njëzet e tetë milion e katërqind e njëzet e nëntë mijë e gjashtëdhjetë e shtatë .37) lekë pa TVSH.

Argumentim:

Për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe V.K.M. Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 76, sipas të cilit përcaktohet se në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave të punimeve, rezultoi vlera e përgjithshme e kontratës. Çmimet e përdorura në preventiv janë në përputhje me çmimet e "Sistemit të integruar të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim" i përcaktuar në pikën 2, të nenit 19, të VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim"

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 3 (tre) muaj.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kriterëve në Shtojcën 7 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit: $0,40 \times 28,429,067.37 = 11,371,626.95$ (njëmbëdhjetë million e treqind e shtatëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë .95) lekë pa TVSH.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 dhe për vitin 2025 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni,

si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020 date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, neni 76 për kriteret detyruese për skualifikim, si dhe Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Përsistemin e taksave vendore”, I ndryshuar.

2.2.3 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore të 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të çertifikuar nga organet tatimore si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: “c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 49 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: 13 930 243(Trembedhjetë milion e

nenteqind e tridhjetë mijë e dyqind e dyzet e tre) lek pa TVSH dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht : 56 858 134 (pesëdhjetë e gjashtë milion e tetëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e katër) lek pa TVSH.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën pëqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer).
- Kontratë sipërmarrje;
- Situacion përfundimtar;
- Faturat tatimore të deklaruar në oragnet tatimore;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer).
- Kontratë sipërmarrje;
- Situacion përfundimtar;
- Faturat tatimore të deklaruar në oragnet tatimore;
- Akt kolaudimi objekti.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.

Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 49% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben oferten te kualifikueshme. Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.” AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (a dhe b), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Lidhur me këtë kërkesë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë bashkë me situacionin e punimeve të ngjashme edhe faturat tatimore të deklaruar në oragnet tatimore respektive të situacioneve.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku qartazi përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, **autoritetet ose entet**

kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe sa dyfishi i vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruar në oragnet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nënkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nënkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nënkontraktimit lëshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qënë palë në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qënë Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjell kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jenë të paplotësuar sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ku

ndër të tjera përcaktohet se: ***Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.***

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga *Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë* në bazë të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

N.P – 1 A Punime gjurmimi në tokë

NP – 4 A Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, dhe pista aeroportuale

N.P – 5 A Punime nëntokësore, ura e vepra arti

NP – 11 A Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

Për punimet speciale të ndërtimit

NS – 5 A Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut

NS – 6 A Sinjalistikë rrugore jondriçuese

NS – 18 A Punime topogjeodezike

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësimin e licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008 ”Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8 402, datë 10.09.1998 ”Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, ku neni 8 përcakton ”Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të

huaj të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimi. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomikë të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko – profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP - 1	<i>Punime gjërmimi në tokë</i>	- Gjërmim dheu themele e plinta me b>2m, ekskavator me goma 0.25m ³ ,shkarkimi ne toke -Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri	A (0 – 20 milion lekë)	Sipas vlerave preventivit
NP – 4	<i>(Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, dhe pista aeroportuale)</i>	-Shtrese stabilizant t=10cm -Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri -Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri - Beton C16/20 (Me cakell) Beton C-20/25 (Me zall)	A (0 – 20 milion lekë)	Sipas vlerave preventivit
NP - 5	<i>Punime nëntokësore, ura e vepra arti</i>	Themel e xokol betoni C 12/15, Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 20/25 Mur guri ne lartesi deri 3m me llaç çimento M 25 F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm	A (0 – 20 milion lekë)	Sipas vlerave preventivit

NP – 11	<i>Ndërtim për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë</i>	Punime Ndricimi Referuar Të gjitha punimeve elektrike sipas preventivit	A (0 – 20 milion lekë)	Sipas vlerave preventivit
NS – 5	<i>Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut</i>	Referuar Të gjitha punimeve elektrike sipas preventivit	A(0 – 20 milion lekë)	Sipas vlerave preventivit
NS – 6	<i>(Sinjalistika rrugore jondriçuese)</i>	- Vijëzim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 12 cm. Bikoponente (sprajt)	A (0 – 20 milion lekë)	Sipas vlerave preventivit
NS - 18	<i>(Punime topogjeodezike)</i>	Punimet Referuar projektit dhe specifikimeve teknike	A (0 – 20 milion lekë)	Sipas vlerave preventivit

Shënim: Pika e licencës për punime topogjeodezike është kërkuar për shkak se kemi të bëjmë me infrastrukturë rrugore dhe projekti parashikon përmirësimin e gjeometrisë horizontale dhe vertikale të rrugës. Piketimi dhe kontrolli topografik duhet bërë në çdo fazë të zbatimit të punimeve.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier në profilet e ndërtimit (Inxhinier Ndërtimi)
- 1 (një) ing. Elektrik
- 1 (një) ing Topograf/ Gjeodet/Markshajder

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune
- Diplomë universitare
- Librezë pune
- CV

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar përsa i takon ndalimeve të dypunësimit. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarinimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë të sipërcituar).

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë.
- **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë.
- **Inxhinieri Topograf/Gjeodet/Markshajder** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë

Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune;
- b) Kontratë pune e vlefshme;
- c) Diplomë.

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë

në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt).

Argumentimi: *Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.*

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohe ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e liçencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- 1 (një) Teknik Ndërtimi të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.

- **2 (dy) Manovrator** të specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin dëshmi nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, kontratë individuale pune. *(në rastin kur punonjësit Manovrator janë të kontraktuar me kontratë pune, respektivisht për mjetet e marra me qera/ kontratë furnizimi, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.)*

- **2 (dy) punëtor asfalti** të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik të lëshuar nga ISHTI ose nga ekuivalente me të, kontratë individuale pune si dhe librezë pune.

- **1 (një) shofer kamioni** të pajisur me lejen e drejtimit përkatëse, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, kontratë individuale pune. *(në rastin kur punonjësit Shofer janë të kontraktuar me kontratë pune, respektivisht për mjetet e marra me qera/ kontratë furnizimi, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.)*

- **2 (dy) elektrikist** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.

- **1 (një) hidraulik** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin*”.

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet të disponojë stafin e sipërcituar në varësi të punimeve që ka marrë përsipër të realizojë sipas ndarjes së punimeve.).

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Tekniku i ndërtimit** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Manovratorët** janë të nevojshëm për manovrimin e mjeteve të rënda që do të përdoren gjatë zbatimit të punimeve. Bazuar në orët e punës që dalin nga zbërthimi zë më zë i preventivit dhe afatit të punimeve rezultojnë të nevojshëm 2 manovratorë.
- **Shoferët** janë të nevojshëm për manovrimin e mjeteve (kamionave) që do të përdoren gjatë zbatimit të punimeve. Bazuar në orët e punës që dalin nga zbërthimi zë më zë i preventivit, afatit të punimeve si dhe sasisë së materialeve që do të transportohen rezultojnë të nevojshëm 1 shoferë.
- **Punëtorët e asfaltit** janë të nevojshëm për shpërndarjen e asfaltit dhe binderit në rrugë. Bazuar në orët e punës që dalin nga zbërthimi zë më zë i preventivit dhe afatit të punimeve rezultojnë të nevojshëm 2 punëtorë asfalti.
- **Punonjes hidraulik** prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike. (Hidrauliku nevojitet kryesisht për ndonjë difekt që mund të ndodh gjatë punimeve me ndonjë tub në zonë i cili mund të kaloj në rrugë).
- **Punonjes elektrikist** prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

Kategorizimi i profesionit të punonjësve është bërë bazuar në kodet e përcaktuara në VKM 514 datë 15.09.2017, si më poshtë:

3119.15 Teknik ndërtimi (Grup njësi “Teknikë të shkencës së fizikë dhe inxhinierisë të pa klasifikuar diku tjetër” Kodi i profesionit: 3119) Funksionet kryesore: Teknikët e këtij grupi kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës: a) Mbledhin të dhëna dhe japin mbështetje teknike për të kontribuar në përdorimin sa më efikas, të sigurtë dhe ekonomik të burimeve njerëzore dhe materiale, por edhe të pajisjeve. b) Kontribuojnë me anë të komenteve dhe sugjerimeve për vendosjen dhe planimetrinë e linjës së punës duke pasur parasysh procesin e caktuar që zhvillohet. c) Zbatojnë metoda pune dhe një seri veprimesh për të kryer detyrat e caktuara. d) Mbikëqyrin ecurinë dhe vazhdimësinë e metodave dhe planeve të punës së përcaktuar. e) Ndihmojnë në identifikimin e kërcënimeve për sigurinë dhe prezantojnë procedurat dhe pajisjet e sigurisë tek punonjësit e tjerë. f) Manovrojnë pajisje të ndryshme që prodhojnë produkte dhe nënprodukte të produkteve të para. g) Montojnë pajisjet dhe materialet sipas procedurës së përcaktuar për të prodhuar produktin final. h) Kryejnë teste laboratorike dhe shënojnë rezultatet në regjistrat përkatës. i) Përgatisin preventivë të detajuar të sasive dhe kostove të materialeve dhe punës së nevojshme për kryerjen e punës me saktësi dhe efikasitet. j) Monitorojnë aspektet teknike, rregullatore dhe ato të sigurisë së ndërtimit, instalimit, manovrimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të materialeve dhe pajisjeve. k) Ndihmojnë në dizenjimin dhe planifikimin e materialeve, metodave dhe planeve të punës. l) Respektojnë

politikat e brendshme të punës dhe procedurat e hartuara nga Institucioni. m) Zbatojnë kodin e etikës të miratuar nga drejtuesit. n) Zbatojnë rregullat e sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit. o) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Kërkesat për punësim: a. Zakonisht kërkohet të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale; në disa raste një diplomë nga një shkollë e mesme e përgjithshme dhe eksperiencë pune disa vjeçare është gjithashtu e vlefshme.

Manovratorët (drejtuesit e makinerive të rënda eksavatorit/ fadromës, makinave ngjësëse dhe të asfaltimit) dhe shoferat e kamionit (Grupi-njësi (Profesioni) “Shoferë të makinave të rënda dhe kamionëve” Kodi i profesionit: 8332)

8332.03 Drejtues të makinave të asfaltimit

8332.06 Drejtues të makinave të ngjeshjes (rrula)

8332.14 Shofer kamioni

Kërkesat për punësim a. Të jetë e/i pajisur me leje drejtimi të nivelit përkatës. b. Zakonisht kërkohet përfundimi i një shkolle profesionale në këtë fushë. c. Të ketë kryer një kurs formimi profesional për këtë profesion. d. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

7119.15 Punëtor asfaltimi në rrugë (Grup njësi - Punëtorë ndërtimi të paklasifikuar diku tjetër) y) Kryejnë asfaltime apo punime mirëmbajtje në rrugë;

Kërkesat për punësim: a. Zakonisht kërkohet përfundimi i një kualifikimi profesional për këtë profesion. b. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur për çdo zë punimesh, bazuar në afatin përkatës të grafikut të punimeve.

Vendosja e këtyre kriterëve për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është përlllogaritur si dhe mjeteve të kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

Kërkesa që punonjësit të jenë me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) të lëshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë është bërë bazuar duke vlerësuar se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme.

Kërkesa për dëshmitë e drejtuesve të mjeteve të rënda bazohet ne Urdhërin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”

2.3.6 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë që në stafin e tyre kanë punonjës që disponojnë certifikata si më poshtë:

- a) **1 (një) punonjes** i pajisur me certifikate “**Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave**” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave")*.
- b) **1 (një) punonjës** i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë certifikatën si “**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**”, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë")*.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e punës,
- diplomën/certifikatën përkatëse.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi : Kërkesa e shkronjës d) të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

2.3.7 Operatori/ët ekonomik duhet të vërtetojnë që në stafin e tyre kanë punonjës që disponojnë certifikata si më poshtë 1 (një) specialist “Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin” në përputhje me klauzolat Ligjit Nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin).

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e punës,
- diplomën/certifikatën përkatëse.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, ku citohet se : “Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep certifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit”.

Theksojmë se, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: punime elektrike, saldimi etj të cilat kanë potencial të shkaktojnë aksidente me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domosdoshme prania e **1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin**. Gjithashtu ky kriter nevojitet duke qenë se gjatë shtrimit të shtresave asfaltike punohet në prani të temperaturave të larta dhe rreziku i zjarrit është gjithmonë dhe prezent duhet të jetë një ekspert zjarrfikës që të veprojë në raste të mundshme të zjarrit.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë një numër mesatar prej jo më pak se 20 (njëzet) punonjës të siguruar për 3 (tre) mujorin e fundit (duke përfshirë edhe stafin teknik të sipërcituar). Për t’a vërtetuar këtë duhet të paraqesë :

a) Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore/ose Tatimore.

b) Listpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar më sipër dhe të jenë të konfirmuara nga Dega Rajonale Tatimore ku është i regjistruar subjekti.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar si dhe referuar grafikut të punimeve të hartuar nga projektuesi, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Numri i punonjësve është vendosur bazuar në sasinë e çdo zëri punimesh në preventiv dhe në natyrën e objektit të kësaj kontrate, pasi nga zbërthimi i zërave të preventivit dhe afati i parashikuar i punimeve janë gjithsej 7938 orë pune punëtori dhe 1104 orë pune makineri, për të cilat nevojiten 20 (17+3) punonjës, ku përfshirë dhe stafin teknik nevojiten në total të paktën 20 punonjës.

KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE.	NJËSIA	SASIA	Ore pune punetori	Ore pune total punetori	Makineri	Ore pune makineri	Ore pune total makineri
	1. PUNIME SHITESASH							
3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m2	350	0,075	26,25	Grejder, Autobot, Rul (kompresor) me vibrim	0,073	25,55
3.969	Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri	m2	3300	0,01	33	Makineri per skarifikim shtresash rrugore	0,038	125,4
3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m2	1100	0,075	82,5	Grejder, Autobot, Rul (kompresor) me vibrim	0,073	80,3

	SHUMA 1:				0			0
	2. PUNIME TE NDRYSHME				0			0
3.620	Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka	m2	350	2,14	749			0
3.616	F V bordura betoni 12x25cm	m	500	0,75	375			0
3.654	Furnizim, vendosje tuba plastmasi ø 100	m	200	0,31	62			0
	SHUMA 2:				0			0
	3. ANALIZA TEKNIKE				0			0
3.222/2	Shtrese binderi me granil gur kave, 6cm, me makineri	m2	4580		549,6			105,34
				0,12		Rul (kompresor) me vibrim	0,023	
3.226/1	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	m2	4580		435,1			77,86
				0,095		Autobitumatriçe, Asfaltoshtruese, Rul (kompresor) me vibrim	0,017	
	SHUMA 3:				0			0
	4. B. SINJALET HORIZONTALE				0			0
3.942	Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm. Bikoponente (sprajt)	ml	2100		210			210
				0,10		Sperkates boje per vizime ne rruge	0,1	
	SHUMA 4:				0			0
	5. PRODHIMI I MATERIALEVE TE NDERTIMIT				0			0
1.30/p	Beton C-20/25 (Me zall)	m3	16		18,24			1,6
				1,14		Fabrike betoni 30 m3/h	0,1	

1.86/p	Pergatitje hekur betoni i zakonshem Ø > 12 mm2	kg	1910		57,3	Makineri kthim hekuri, Elektro argano, Vinc, Makineri prerje e drejtim hekuri	0,0074	14,134
				0,03				
1.29/1	Beton C16/20 (Me cakell)	m3	10		11,4	Fabrike betoni 30 m3/h,	0,1	1
				1,14				
	SHUMA 5:				0			0
	6. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT+KANALIZIME				0			0
3.596	Pastrim kanali ekzistues ne skarpate, me krahë (dy herë në vit)	m3	225		720			0
				3,20				
	SHUMA 6:				0			0
	7. LINJA T/L GERMIMI I GROPAVE TE SHTYLLAVE				0			0
3.558	Spostim shtylle elektrike (Cmontim dhe montim shtylle elektrike prej betoni perfshire linjat dhe aksesoret)	copë	20		244	Traktor terheqes, Autovinc deri 5 ton	3,2	64
				12,20				
	SHUMA 7:				0			0
	8. D. SINJALET DHE PAJISJET SHITESH. NGADALESHUESIT E SHPEJTESISE				0			0
3.604	F.V kangjell ne trotuar (struktura metalike e lyer me boje)ne zonat e shkollave	ml	167		374,08			0
				2,24				
3.955	FV tabela te ndryshme rrugore D=60cm	copë	4		2			0
				0,50				
	SHUMA 8:				0			0
	9. PUNIME DHEU				0			0
2.25	Germim dheu themele e plinta me b>2m, ekskavator me goma 0.25m3,shkarkimi ne toke	m3	112		0	Ekskavator 0.25 m3	0,067	7,504
2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	112		0			0
	SHUMA 9:				0			0

	10. PUNIME BETONI DHE B/A				0			0
2.262/4 a	Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 20/25	m3	560		1937,6			280
				3,46		Vibrator,	0,5	
2,11	Themel e xokol b/betoni C - 12/15	m3	40	9,31	372,4	Vibrator	0,9	36
	SHUMA 10:				0			0
	11. PUNIME BOJATISJE				0			0
2.447	Kallepe per mure b/a	m2	57	2,06	117,42			0
2.447	Kallepe per mure b/a	m2	204	2,06	420,24			0
	SHUMA 11:				0			0
	12. TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA				0			0
3.169	F V shtylla metalike per ndricim, H=7m, d=160mm	copë	10	1,80	18			0
3.174	FV krah dy degesh per shtylla metalike	copë	10	1,20	12	Autovinc deri 2.5 ton	0,1	1
3.175	FV ndricues Smart VP CL1 CR M-S 250Ë GG FAE 44004,me llampe 250Ë 230V	copë	10	2,00	20	Autovinc deri 2.5 ton	2	20
3.182	FV elektroda tokezimi te xinguar 50x3mm L=150cm	copë	10	0,40	4			0
3.176	FV pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086	copë	10	1,90	19			0
	SHUMA 12:				0			0
	13. GAZ E NAFTESJELLES				0			0
4.131/1 .5	F.V.ne toke kablllo Cu fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulose plastmasi, te armuar, 2x10mm2	m	200	0,40	80			0
	SHUMA 13:				0			0
	14. INSTALIME PER NDRICIM				0			0
2.480/5	F.V tub plastmasi Ø 31-36mm	ml	200	0,43	86			0
2.490/1 a	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 10A	copë	10	1,30	13			0
	SHUMA 14:				0			0
	15. PUNIME HEKUR BETONI				0			0

2.166/1 a	F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm	ton	1	42,00	42	Vinc kulle 6 - 10 ton,	0,63	0,63
	SHUMA 15:				0			0
	16. PUNIME MURATURE GURI				0			0
2.54/2	Mur guri ne lartesi deri 3m me llaç çimento M 25	m3	52	16,30	847,6	Vinc	1,04	54,08

3 muaj * 22 ditë pune/ muaj = 66 ditë pune

66 ditë pune * 8 orë pune/ dita = 528 orë pune

7938 orë totale punëtor / 528 orë pune = 15 punëtor

1104 orë totale makineri / 528 orë pune = 2,09 ≈ 2 manovrator

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Vinç	copë 1	Në pronësi/me qira/kontrat shërbimi
Autovinç deri 2.5 ton	copë 1	Në pronësi/me qira/kontrat shërbimi
Vinç kullë 6-10 ton	copë 1	Në pronësi/me qira/kontrat shërbimi
Spërkatës boje	copë 1	Në pronësi/me qira/kontrat shërbimi
Asfaltoshtuese	copë 1	Në pronësi/me qira/kontrat shërbimi
Autobitumatriçe	copë 1	Në pronësi/me qira/kontrat shërbimi
Sperkates boje per vizime ne rruge	copë 1	Në pronësi/me qira/kontrat shërbimi
Fabrike betoni 30 m3/h	copë 1	Në pronësi/me qira/kontrat furnizimi betoni
Grejder	copë 1	Në pronësi/me qira/kontrat shërbimi
Rul (kompresor)me Vibrim	copë 1	Në pronësi/me qira/kontrat shërbimi
Makineri skarifikim shtresash	copë 1	Në pronësi/me qira/kontrat shërbimi
Autobot	copë 1	Në pronësi/me qira/kontrat shërbimi
Vibrator	copë 1	Në pronësi/me qira/kontrat shërbimi
Makineri kthim hekuri	copë 1	Në pronësi/me qira/kontrat shërbimi
Elektro argano	copë 1	Në pronësi/me qira/kontrat shërbimi
Makineri prerje e drejtim hekuri	copë 1	Në pronësi/me qira/kontrat shërbimi
Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 Ton	copë 1	Në pronësi/me qira/kontrat shërbimi
Ekskavator 0.25 m3	copë 1	Në pronësi/me qira/kontrat shërbimi
Traktor terheqës	copë 1	Në pronësi/me qira/kontrat shërbimi
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 Ton	copë 1	Në pronësi/me qira/kontrat shërbimi
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5-10 Ton	copë 1	Në pronësi/me qira/kontrat shërbimi
Matrapik	copë 1	Në pronësi
Jelek	copë 20	Në pronësi

Tabela sinjalizuese rrugore	copë 10	Në pronësi
Kuti ndihme e shpejtë	copë 2	Në pronësi

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës si më poshtë ;

- **Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet :**
 - a) Dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
 - b) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
 - c) Çertifikatën e kontrollit teknik të mjetit (SGS) e vlefshme
 - d) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
 - e) Taksat vjetore të mjetit (e vlefshme)
 - f) Liçencë transporti
 - g) Çertifikatë transporti nga njësia vendore për mjetet që duhet ta disponojnë sipas dispozitave në fuqi (i vlefshëm)
 - h) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij
- **Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë me qira ose kontrata shërbimi apo furnizimi, duhet të paraqitet:**
 - a) Kontrata e qerasë
 - b) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
 - c) Çertifikatën e kontrollit teknik të mjetit (SGS) (e vlefshme)
 - d) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
 - e) Taksat vjetore të mjetit (e vlefshme)
 - f) Liçencë transporti (për transport mallrash për të tretë dhe me qera);
 - g) Çertifikatë transporti nga njësia vendore (për transport mallrash për të tretë dhe me qera); (e vlefshme)
 - h) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë, kontratë shërbimi apo marrjen me qira të tyre **(fatura tatimore blerje, akte ç’doganimi, kontrata noteriale)**
- Për mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë vendodhjen e mjeteve, me qëllim verifikimi në çdo kohë prej Autoritetit Kontraktor deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës së makinerive.
- Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. **Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak s’kualifikimi.** Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

- Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar *"Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin"*.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *"Për prokurimin publik"* dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"*, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si me poshtë:

- ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë
- ISO 14001:2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor
- ISO 45001:2023 Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë
- BS ISO 39001:2012 Per sistemin e menaxhimit te sigurise ne trafikun rrugor

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e mësipërme)*. **Çertifikatat e lëshuara nga organizma të pa akredituara do të konsiderohen kusht skualifikimi.**

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma "a"- "e" janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *"Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë"*, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285,

datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2023 është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2023 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi

BS ISO 39001:2012 Kjo certifikatë mundëson që kompanitë të punojnë me sistemet e qarkullimit rrugor, të reduktojnë dhe të përjashtojnë rreziqet e humbjes të jetes dhe plagosjeve në lidhje me aksidentet gjatë procesit të punës.

Argumentimi i specifikimeve teknike : *Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës, bashkëngjitur DST në SPE.*

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës dhe shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe materialeve, bazuar në VKM-në të VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.

NJËSIA E PROKURIMIT